



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 5, Datë 20.02.2017

Për

VENDOSJEN E NJË PLLAKE PËRKUJTIMORE NË KUJTIM TË TAKIMIT HISTORIK TË PËRFAQËSUESVE TË BASHKISË SË TIRANËS ME QEVERINË E DALË NGA KONGRESI HISTORIK I LUSHNJES (SHKURT 1920)

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1.7, shkronja “a”, nenit 23 pika 9, nenit 25 pika 1, nenit 54 shkronja “m” dhe nenit 55 pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore”, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin mbi vendosjen e një pllake përkujtimore në kujtim të takimit historik të përfaqësuesve të Bashkisë së Tiranës me qeverinë e dalë nga Kongresi Historik i Lushnjes (shkurt 1920), Këshilli Bashkiak i Tiranës ,

V E N D O S I:

1. Të miratojë propozimin për vendosjen e një pllake përkujtimore në vendin e quajtur “Qafë Kasha” me këtë përmbajtje:

“NË KËTË VEND QYTETARËT E TIRANËS DHE DREJTUESIT E BASHKISË SË SAJ PRITËN DHE MORËN NË MBROJTJE PËRFAQËSUESIT E ORGANEVE DREJTUESE TË SHTETIT SHQIPTAR, TË ZGJEDHUR NGA KONGRESI I LUSHNJËS, TË CILAT FILLUAN VEPRIMTARINË NË NDËRTESAT E KËTIJ QYTETI.

MË 11 SHKURT 1920 TIRANA U SHPALL KRYEQYTETI I SHQIPËRISË”.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI